

**VENDIM**

Nr. 213, datë 11.3.2020

**PËR CAKTIMIN E INSTITUTIT
KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË
KULTURORE SI NJËSI ZBATUESE,
DHE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E RESTAURIMIT/
RINDËRTIMIT TË PASURIVE
KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), si njësi zbatuese për rindërtimin/restaurimin e pasurive kulturore në njësitë territoriale të bashkive Tiranë, Durrës, Kavajë, Krushjë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Rrogozhinë



e Vorë, dhe përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit/restaurimit të pasurive kulturore, gjithsej, në vlerën 236 627 069 (dyqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, përkatësisht:

a) Vlerën prej 197 500 584 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH, për:

i. hartimin e projekteve të detyruara për restaurimin/rindërtimin e pasurive kulturore, të dëmtuara;

ii. rishikimin e projekteve të hartuara për restaurimin/rikonstruksionin e objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara;

iii. realizimin e studimeve të thelluara komplekse, përfshirë studime gjeologjike, rievime me aparatura bashkëkohore, sisteme monitorimi të strukturave, të objekteve pasuri kulturore, të dëmtuara.

b) Vlerën prej 39 126 485 (tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për realizimin e veprimtarive arkeologjike (vëzhgim sipërfaqësor, sondazhe arkeologjike dhe monitorim) në zonat e përcaktuara për hartimin e planeve të detyruara vendore.

3. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama